



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 166, datë 18.3.2022

PËR

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE
ARSIMORE NË BASHKINË KAMZË DHE CAKTIMIN E BASHKISË
KAMZË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamzë, në masën 996 684 324 (nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Për rindërtimin (zbatimin, projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin) e shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari", njësia administrative Babrru, Bashkia Kamzë, në masën 501 596 868 (pesëqind e një milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë;
- b) Për rindërtimin (zbatimin, projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin) e shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit", njësia administrative Paskuqan, Bashkia Kamzë, në masën 286 531 800 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind) lekë;

- c) Për rikonstruksionin (zbatimin, projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin) e gjimnazit "Gramoz Palushi", njësia administrative Paskuqan, Bashkia Kamzë, në masën 208 555 656 (dyqind e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.
2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondit në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 199 336 865 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit (zbatimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit) të objekteve arsimore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.
3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit (zbatimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit), sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1563/1
DATË 18.3 - 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

